



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 15

Prishtinë, më 13.02.2018, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S 2

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Hajdar Beqa, Bahrim Shabani, Sami Kurteshi, Arben Gashi, Korab Sejdiu, Nezir Çoçaj, Igor Simić, Shkumbin Demaliaj dhe Bilall Sherifi.

Munguan: Glauk Konjufca.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Nita Latifi-Praktikante, Valbona Bytyqi-Ekonomia Online, Hermonda Kalludra-Balkans Group, Drita Vitia-Radio Kosova, Genc Nimoni-Çohu, Bardha Maxhuni-GSJP, Rinor Beka-NDI, Blerta Bejtullahu-EUSR-EUoffice, Shefki Kastrati-NDI, Norë Shabani-Koha Ditore, Gëzim Shala-IKD, Albert Krasniqi-KDI, Sanije Berisha-OSCE.

Nga Stafi i Komisionit: Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Diskutim lidhur me Draft-Rregulloren e Kuvendit;
3. Formimi i grupeve punuese për Projektligjin nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik dhe Projekt-Kodin e Drejtësisë për të Mitur nr. 06/L-006;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetarja-njoftoi anëtarët e komisionit për propozimin që të formohet grupi punues për amendamentimin e Ligjit për Familjen ku tha se ky propozim është në kuadër të planit të punës së komisionit dhe gjithashtu njoftoi anëtarët e komisionit edhe për propozimet për anëtarë të provimit të jurisprudencës ku tha se emrat tashmë janë në kuvend dhe do të shyrtohen në mbledhjen e radhës.

Kryetarja- konstatoi se rendi i ditës u miratua me ndryshimet e propozuara.

2. Diskutim lidhur me Draft-Rregulloren e Kuvendit;

Hajdar Beqa-Njoftoi anëtarët e komisionit rreth punës që është bërë për Rregulloren e Kuvendit, ai tha se si pikë diskutabile në punëtorinë e fundit ishte se a duhet të jetë i përfshirë Ligji për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit në këtë rregullore apo të mos jetë fare i përfshirë. Deputeti Beqa tha se nëse vendoset që të mos jetë i përfshirë ligji në rregullore atëherë duhet të propozojmë që Komisioni për Legjislacion të merr iniciativë për plotësim ndryshimin e ligjit në mënyrë që rregullorja dhe ligji të jenë në rrugë të drejtë juridike.

Albulena Haxhiu- tha se LVV-ja konsideron që Ligji për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit rregullon çështje tjera nga Rregullorja e Punës së Kuvendit. Duke ditur që Gjykata Kushtetuese ka pezulluar disa nene që kanë të bëjnë me privilegjet e deputeteve ku edhe e kemi përshëndetur, ne konsiderojmë se është e panevojshme përfshirja e Ligjit për Përgjegjësitë dhe të Drejtat e Deputetit në Rregulloren e Kuvendit tha deputetja Haxhiu. Ajo me tej shtoi duke thënë se në rregullore duhet të përfshihen çështjet që kanë të bëjnë me funksionimin e Kuvendit. Ajo tha se është e rëndësishme të miratohet Rregullorja e Punës së Kuvendit dhe do të japim kontributin tonë në këtë drejtim.

Arben Gashi-tha se janë tri çështje që duhet sqaruar, çështja e parë është në lidhje me atë që tha z. Beqa, citoj: “është imediate miratimi i Rregullores së Kuvendit”, ka dhjetë vite që kjo rregullore është në kuvend dhe për një moment thuhet se është imediate miratimi i saj me dy tema që janë mjaft problematike. E para është çështja e Konferencës së Kryetarëve e cila parashihet në Rregulloren e re të Punës së Kuvendit dhe e cila duhet të trajtohet me kujdes të shtuar kur dihet se cilat janë pasojat që mund të prodhojë kjo strukturë e re brenda organizimit të kuvendit dhe mënyra e funksionimit të saj dhe çështja e dytë është te përgjegjësitë e deputetit ku edhe është dilema se duhet të rregullohet me rregullore apo me ligj të veçantë. Ai tha se ligji nuk mund të jetë pjesë e rregullores sepse kjo është procedurë e veçantë ku duhet të behet akti i shfuqizimit të ligjit që është në fuqi, por nëse duhet rregulluar pjesa e përgjegjësisive të deputetit, llogaridhënja, mënyra e funksionimit dhe çështje tjera që kanë të bëjnë me kompensimin ku për momentin janë të rregulluara me ligj të veçantë dhe nëse duam të rregullojmë ndryshe duhet të shfuqizohet ligji në fuqi. Lidhur me këtë çështje deputeti Gashi propozoi që të procedohet me Rregullore dhe me Ligj për Përgjegjësitë dhe të Drejtat e Deputetit në kohë të njëjtë kur dihet se plotësojnë njëra tjetren theksoi deputeti Arben Gashi.

Albulena Haxhiu- në fjalën e saj të sërishme tha se sa i përket konferencës së kryetarëve ku tha se konsideroj se është arritje një organ i tillë sikur që është konferenca e kryetarëve ku tha se përbërja është nga Kryetari i Kuvendit dhe shefat e grupeve parlamentare ku me këtë rast fuqizohet roli i shefave të grupeve parlamentare, ndërsa Kryesia e Kuvendit ka një rol formal dhe mendoj se kjo është në rregull tha deputetja Albulena Haxhiu. një tjetër arritje në këtë rregullore ajo tha se është edhe dërgimi i emrave nga grupet parlamentare për kryesi të kuvendit, pra nëse Kryetari i Kuvendit propozohet burrë atëherë propozimi i dytë duhet të jetë grua ku tha se kjo është shumë e rëndësishme. Znj Haxhiu gjithashtu përmendi edhe raportet e institucioneve të pavarura ku tha se komisioni ka të drejtë të kërkojë shkarkimin e bordit ose drejtorit nëse raporti nuk kalon në kuvend. Znj Haxhiu tha se ka edhe ndryshime tjera të cilat janë të rëndësishme e sidomos të pyetjet parlamentare ku tha se fuqizohet deputeti në kohën kur parashton pyetjen parlamentare.

Hajdar Beqa-duke iu referuar asaj që tha se është imediate pra miratimi i rregullores tha se si kryesues i grupit punues për rregullore kam paraqitur para jush planin e veprimit ku gjithë komisioni e ka aprovuar dhe është pajtuar që rregullorja të kalojë në komision në të gjitha fazat deri në muajin e katërt, pastaj në takimin me Kryetarin e Kuvendit dhe kryetaret e grupeve parlamentare ku është kërkuar që me Rregullore të vazhdohet me procedurë sa më të shpejtë të mundshme në mënyrë që Rregullorja në muajin shkurt të kalojë në lexim të parë sqaroi deputeti Hajdar Beqa.

Arben Gashi- në fjalën e sërishme duke iu referuar konferencës së kryetarëve tha se nuk ka nevojë të bëhet një trup e cila është e panjohur përderisa ekziston një praktikë e cila funksionon mjaft mirë në Kuvendin e Kosovës, përderisa kemi praktikë të mirë të mbledhjes së përbashkët të kryesisë së kuvendit me kryetaret e grupeve ku tha se është më mirë të normohet kjo praktikë e mirë se sa të eksperimentohet me një praktikë e cila është e panjohur për ne tha deputeti Arben Gashi.

Shkumbin Demaliaj-tha se meqenëse kemi një plan para vetes mendoj se nuk duhet të kthehemi në piken zero perseri. Grupi punues ka perfunduar punën dhe konsideroj se rregullorja duhet të shkojë në lexim të parë që pastaj të mirepresim edhe propozime tjera në mes dy leximeve.

Bilall Sherifi- sa i përket konferencës së kryetarëve që u shtrua si problem nga deputeti Arben Gashi tha, mendoj se është e rëndësishme të ketë konferencë të kryetarëve për faktin se mendimi politik përmes shefave të grupeve është reflektim i vullnetit të votuesve. Ai tha se tani vetëm po i jepet një e drejtë e votës grupeve parlamentare që deri më tani nuk e kanë pasur. Por nëse nuk ka pajtueshmëri në këtë pikë atëherë nuk mendoj se duhet vazhduar deri sa të arrihet një unitet brenda partive politike theksoi z. Sherifi.

Sami Kurteshi-Tha, mendoj se shqetësimi i z. Gashi lidhur me konferencën e kryetarëve duhet të mbetet si nën i diskutueshem sepse duhet të merren parasysh shqetësimet edhe të deputetëve por edhe të grupeve parlamentare, megjithatë duhet të vazhdojmë të diskutojmë për çështjet me të cilat po pajtohemi.

Pas diskutimeve komisioni vendosi që me pesë(5) vota për, një (1) votë kundër dhe një (1) apstenim të hiqet Kapitulli i Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit nga

Rregullorja e Punes së Kuvendit, gjithashtu u vendos që punëtorja të vazhdojë punimet me datë 14.02.2018 në ora 10:00.

3. Formimi i grupeve punuese për Projektligjin nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik dhe Projekt-Kodin e Drejtësisë për të Mitur nr. 06/L-006;

Pas diskutimeve Komisioni, vendosi që për shqyrtimin e Projektligjit nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik dhe Projekt-Kodin e Drejtësisë për të Mitur nr. 06/L-006, të formojë grupet punuese si vijon:

I. Formohet grupi punues për Projektligjin nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik me këtë përbërje:

- 1. Sami Kurteshi-kryetar**
- 2. Nezir Çoçaj-anetar**
- 3. Bilall Sherifi-anetar**

II. Formohet grupi punues për Projekt-Kodin e Drejtësisë për të Mitur nr.06/L-006 me këtë përbërje:

- 1. Shkumbin Demaliaj-kryetar**
- 2. Hajdar Beqa-anëtar**
- 3. Igor Simic-anëtar**
- 4. Sami Kurteshi-anëtar**

III. Formohet grupi punues për hartimin e Projektligjit për Familjen me këtë përbërje:

- 1. Korab Sejdiu-kryetar**
- 2. Albulena Haxhiu-anetare**
- 3. Bahrim Shabani-anëtar**
- 4. Bilall Sherifi-anëtar**

5. Të ndryshme.

Korab Sejdiu- në këtë pikë theksoi urgjencën e caktimit të takimit lidhur me pikën e rendit të ditës për provimin e jurisprudencës ku tha se ka me qindra juriste të cilët janë në pritje ti nënshtrohen këtij provimi, prandaj konsideroj se kjo është një çështje shumë e rëndësishme që të shtyhet përpara potencoi deputeti Korab Sejdiu.

Mbledhja përfundoi në orën 14.10

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Albulena Haxhiu